

**ARJAN SHUMELI,
LULJETA MINE**

**METODAT E PËRKUFIZIMIT TË TERMINOLOGJISË
SË AGROMEKANIKËS**

Hyrje

Teoritë mbi lindjen dhe zhvillimin e terminologjisë janë të shumta. Kjo për vet faktin se terminologjia ka hapur një fushë të re kërkimore e studimore duke tërhequr interesin e gjuhëtarëve në gjurmimin dhe inventarizimin e termave në çdo fushë të dijes dhe të shkencës. Interesi i gjuhëtarëve në fushën e terminologjisë është i kahershëm, por vetëm në shekullin e 20-të pretendohet se *terminologjia filloi të zhvillohej si disiplinë e pavarur*. Nga këndvështrimi etimologjik, terminologjia nënkupton shkencën, studimin dhe njohuritë për *termat*, gjë që do ta njësonte atë me leksikologjinë dhe leksikografinë, të cilat kanë si synim ‘mbledhjen e të dhënave rreth leksikut të një gjuhe’ duke siguruar informacion dhe shërbim ‘këshillimor’ për përdoruesit e gjuhës. Në këndvështrimin historik, përdorimi i parë i shënuar i terminologjisë është ai që i referohet *fjalorit teknik*, d.m.th një bashkësie termash që mbartin një koherencë të caktuar, ku termat i përkasin një fushe të ngushtë dhe të specializuar të dijes.

Edhe pse terminologjia është e lidhur ngushtë me gjuhësinë dhe semantikën, ajo veçohet si fushë e mëvetësuar studimi¹ duke u pozicionuar si fushë ndërdisiplinore. Terminologjia, sipas E. Vyster²-it, përfaqëson ‘një fushë ndërdisiplinore të studimit që ndërmjetëson lidhjen midis shkencave të gjuhësisë, logjikës, ontologjisë dhe informatikës me fusha të ndryshme të dijes’. Elementi i përbashkët midis këtyre disiplinave është se secila prej tyre merret me organizimin formal të marrëdhënieve komplekse midis koncepteve dhe termave’. Terminologjia nënkupton studimin dhe fushën e aktiviteteve që merren me mbledhjen, përshkrimin, përpunimin dhe

¹ H. Felber, *Terminology manual*, UNESCO and Infoterm, Paris, 1984.

² E. Wüster, *The machine tool – An interlingual dictionary of Basic concepts*. London: technical Press, 1931.

paraqitjen e termave, pra të njëjste leksikore që i përkasin një fushe të specializuar përdorimi të një ose më shumë gjuhëve³.

Në bazë të fushave të dijes, leksiku terminologjik, si pjesë e rëndësishme e leksikut të gjuhës standarde shqipe, përbën një tërësi nënsistemesh, të identifikuar e të diferencuara si entitete më vete në bazë të strukturimit të fushave të veçanta të dijes⁴. Brenda sistemit të gjerë dhe të shumanshëm të leksikut terminologjik mund të veçojmë leksikon e agromekanikës, i cili paraqitet si një leksik i pasur, homogjen, me taban në gjuhën shqipe për nga mënyra e temëformimit, elastik dhe në zhvillim të pareshtur, me tiparet dhe karakteristikat e veta. Agromekanika, si mikrofushë e bujqësisë, shfaqet si fushë e ndërmjetme midis bujqësisë dhe mekanikës duke paraqitur interes historik dhe gjuhësor, sepse synon të gjurmojë historikun e lindjes, të zhvillimit, pasurimit, njësimin e standardizimit të termave të veglave bujqësore të përdorura nga shqiptarët qysh në lashtësi. Studimi i fjalëve dhe i shprehjeve që lidhen me një sferë të caktuar, siç është bujqësia, paraqitet si një detyrë e rëndësishme dhe e vështirë, sepse tradita bujqësore tek shqiptarët është e lashtë, e përhapur kudo, në fushë dhe në malësi si dhe mjaft e zhvilluar⁵ (Pepa, 2002).

Ndërsa leksikologjia merret me studimin e fjalëve në përgjithësi, terminologjia merret me studimin e fjalëve/termave të gjuhës së specializuar ose të termave që lidhen me fusha të veçanta të dijes dhe shkencës. Leksikografia merret me procesin e hartimit të fjalorëve, kryesisht të fjalëve të gjuhës së zakonshme, por edhe të fjalëve të gjuhës së specializuar (termave). Fjalorët shpjegues përmbajnë edhe fjalë terma të specializuara që ngërthehen me fjalët e gjuhës së zakonshme. Terminografia (ose terminologjia), në anën tjetër, merret ekskluzivisht me përpilimin e fjalëve dhe termave të gjuhëve speciale. Rezultati i kësaj punë shpesh njihet me terma të ndryshëm si: terminologji, “gjuhë e specializuar” ‘glosar teknik’⁵ etj. Pranohet gjithandej se fjala terminologji është një fjalë polisemantike, e cila mund t’i referohet tri objekteve që nuk janë të lidhura mes tyre. Sager-i (1990:3) pranon se terminologjia mund t’i referohet: një vëllimi praktikash dhe metodash që përdoren për mbledhjen, përshkrimin dhe paraqitjen e termave.

³ J. S. Sager, *A Practical course in terminology processing*, John Benjamins Publishing Company, Amsterdam, 1990.

⁴ V. Bello, *Leksiku terminologjik i gjuhësisë në gjuhën shqipe*, Disertacion, Tiranë, 2009.

⁵ *The importance of terminology* tek <http://www.computing.surrey.ac.uk/ai/pointer/report/section1.html>

Metodat e përkufizimit të terminologjisë së agromekanikës

Terminologjitë, si agregate termash që përfaqësojnë sistemet e koncepteve të fushave të ndryshme lëndore, janë mjetet më të rëndësishme⁶ për:


- Sistematizimin e njohurive (d.m.th klasifikimin konceptor për secilën disiplinë shkencore);
- Transferimin e njohurive, aftësive (shprehive) dhe teknologjive;
- Përkthimin e teksteve shkencore;
- Formulimin e informacionit për fushën përkatëse;

Komunikimi i njohurive dhe informacionit të specialistit, qoftë ai monolingual apo multilingual, është i lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me krijimin, shpërndarjen e burimeve terminologjike dhe me menaxhimin e terminologjisë në kuptimin më të gjerë të fjalës. Terminologjia, si disiplinë akademike, ofron koncepte dhe metodologji për përfaqësimin dhe transferimin cilësor dhe efektiv. Në anën tjetër, ajo formon mjetet kryesore për identifikimin, vjeljen, ndarjen në njësi, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e burimeve terminologjike dhe tipave të tjerë të informacionit.

Burimet terminologjike mbartin vlerë në shumë mënyra të tjera: si grumbullim fjalësh, si objekt standardizimi dhe harmonizimi, si input (output) i një numri të gjerë aplikimesh dhe disiplinash, i bazuar tek njeriu apo tek kompjuteri. (*shih grafikun më poshtë*)⁷.

⁶ H. Felber, "Basic principles and methods for the preparation of terminology standards", *Standardization of technical terminology: principles and practices*, Heyman editore, 1983.

⁷ *Rëndësia e terminologjisë*, <http://www.computing.surrey.ac.uk/ai/pointer/report/section1.html>



Karakteristikat e konceptit

Për sa i takon termit si njësi emërtuese e konceptit, në historinë e zhvillimit të leksikut të shqipes, ai është identifikuar i veçuar në kuadrin e fjalës dhe si njësi speciale e përdorur në fusha të ndryshme të dijes⁸. Termi ka një formë gjuhësore dhe përmbajtje që përfaqëson konceptin. Me anë të procesit të emërtimit termit i referohen realitetit konkret dhe abstrakt, një realitet që është i jashtëm dhe i brendshëm, individual dhe kolektiv. Standardi ISO 704 (1987) ‘*Parimet dhe metodat e terminologjisë*’ përcakton rolin e konceptit në klasifikimin që i bënë objekteve individuale në botën e jashtme ose të brendshme me anë të proceseve pak a shumë arbitrare të *abstraksionit*. Pra, ky përkufizim na ndihmon të diferencojmë qartë konceptet nga objektet në botën reale që këto koncepte përfaqësojnë. Sipas këtij orientimi, rezulton se ‘*konceptet janë rezultat i procesit të përzgjedhjes së karakteristikave që bien në sy dhe që përkufizojnë një klasë objektesh dhe jo objekte individuale*’⁹.

Është e rëndësishme që në praktikën terminologjike konceptet të trajtohen si elemente të fushave konceptuale dhe në veçanti si taksonomi

⁸ A. Duro, “Marrëdhëniet fjalë-kuptim dhe term-koncept në këndvështrimin e akademikut Jani Thomai”, *Studimet Gjuhësore-terminologji-gjuhësi kompjuterike dhe kritikë-bibliografi*, Tiranë, 2012.

⁹ M. T. Cabre, *Terminology: Theory, methods and applications*, John Benjamins, 1999.

që kuptohen si grupe të koncepteve të lidhura. Brenda fushës teknike dhe shkencore ndodh që konceptimi strukturalist i fushave leksikore dhe semantike të korrespondojë me natyrën e objekteve gjuhësore¹⁰ (Lerat, 1989). Koncepti është një njësi e përmbajtjes që përmban një numër karakteristikash. Sipas standardit ISO/R (1087), karakteristikat e koncepteve janë tiparet që e përshkruajnë atë. Shprehja e vëllimit të karakteristikave të një koncepti është përkufizimi. P.sh.:

Kazma është

- një vegël e hekurt;
- me dy anë pak të përkulura dhe me bisht të gjatë prej druri; e cila përdoret
- për të gërmuar a për të shembur mure.

Kosa është

- një vegël e thjeshtë bujqësore;
- me një presë të gjatë prej metal pak të harkuar dhe me bisht; që përdoret
- për të kositur barin

Konceptet ndryshojnë nga njëri-tjetri për faktin se ato zotërojnë karakteristika të ndryshme. Një përshkrim i mirë konceptual duhet të përfshijë ballafaqimin dhe kundërvënien e karakteristikave të qarta që dallojnë konceptet. Kjo shprehet si më poshtë vijon:

a. **Spërkatëse shpine është**

- një aparat spërkatës
- i thjeshtë, i lehtë, i vogël për spërkatje të bimëve delikate si lule e farishte
- që mbahet në dorë

b. **Spërkatëse shpine është:**

- aparat spërkatës i thjeshtë
- që mbahet në shpinë
- ku pompa vihet në veprim më dorë

c. **Spërkatëse për traktor:**

- spërkatëse e kompletuar me fuqi motorike
- që vihet në veprim nga boshti i marrjes së fuqisë

Me kapacitet të madh të depozitës

Prania ose mungesa e karakteristikave diferencon konceptet në një sistem konceptual. Nga shembujt e mësipërm, mund të nxjerrim

¹⁰ P. Lerat, «Terminologie et sémantique descriptive», *La banque des mots*, numéro spécial, 1988, p. 11-30.

përfundimin se këto koncepte paraqesin disa karakteristika të njëjta që i përkasin të njëjtës fushë. Jo të gjitha konceptet janë rezultat i bashkimit të karakteristikave të tyre. Në shumë raste, ato dalin si produkte komplekse të një kombinimi konceptesh të thjeshta. Nga këndvështrimi i përshkrimit, konceptet komplekse formohen nga një kombinim setesh të strukturuar karakteristika, ku secila prej tyre përshkruan një koncept të thjeshtë¹¹.

Sipas M. Teresa Cabre-së (1999: 101), kombinimi i koncepteve të thjeshta që përbëjnë koncepte komplekse, na çon tek tri raste që bazohen në transferimin e kuptimit.

Kombinimi i dy koncepteve mund të çojë në një koncept të tretë, i cili është specifik ndaj njërit prej dy koncepteve fillestare (makinë→mbjell: makinë mbjellëse; aparat→spërkat: aparat spërkatës).

Kombinimi i dy koncepteve mund të çojë tek një i tretë, i cili është specifik ndaj dy koncepteve fillestare (vresht→plug: plug vreshtash; kanal→hap: kanalhapës).

Kombinimi i dy koncepteve mund të çojë tek një i tretë, i cili karakterizohet nga tiparet diferencuese të dy koncepteve fillestare që nuk shfaqet specifik ndaj njërit apo tjetrit koncept (korrëse→shirëse: korrëse-shirëse). Në rastin e tretë flasim për shkëputje ose ndarje të koncepteve.

Përkufizimet në terminologji

Teoritë terminologjike pranojnë vetëm një tip përkufizimi, *përkufizimin analitik*, i cili në mënyrë të plotë dhe sistematike identifikon një koncept të vetëm në lidhje me gjithë konceptet e tjera brenda një fushe të caktuar a të specializuar. Në fushën e terminologjisë përkufizimet nuk ndodhin në izolim, ato konsiderohen si pjesë e informacionit të mbledhur për një term të caktuar¹². Për termin *lopatë*, informacioni i mbledhur është ‘*vegël krahu, me pjesë metalike, që përdoret për të hequr diçka dhe për punë bujqësore*’. Përkufizimi është vetëm një pjesë e specifikimit semantik, që mund të plotësohet nga specifikime të tjera morfologjike, sintetike dhe pragmatike. Sipas Sager-it, përkufizimi i një termi nënkupton procesin e emërimit të një koncepti, pra se cili është kuptimi i termit në mënyrë që të bëhet lidhja midis simbolit dhe konceptit. Përkufizimi nevojitet për të vendosur një term në pozicionin e vet në strukturën e duhur

¹¹ M. T. Cabre, *Terminology: Theory, methods and applications*, John Benjamins, 1999.

¹² J. S. Sager, *A Practical course in terminology processing*, John Benjamins Publishing Company, Amsterdam, 1990.

të njohurive. Duke qenë se ky është një aktivitet thjesht terminologjik, ne e quajmë atë *përkufizim termonologjik*. Kjo presupozon një kuptim më të plotë të asaj se pse synohet një term, i cili pa dyshim fitohet nga përkufizimet ekzistuese, nga konteksti, apo nga konsultime me specialistët e fushës dhe nëpërmjet njohurive të fushës përkatëse. Përkufizimi është i nevojshëm për të fiksuar kuptimin e specializuar të termit. Një qëllim tjetër i përkufizimit është që t'i ofrojë jospécialistit një kuptim sa më të plotë të një termi. Ky quhet '*përkufizimi enciklopedik*'. Si rrjedhojë, qëllimi i dhënies së përkufizimit në terminologji lidhet me kriteret e përdoruesit dhe me konceptet që duhet të përkufizohen. Pra, arsyetojmë se *terminologut* i duhet përkufizimi në kontekstin e përpilimit të terminologjive apo kur i kërkohet nga rrethana të ndryshme që ai të propozojë terma të rinj. Në anën tjetër, *përkthyesit* i duhet përkufizimi për të kuptuar tekstin e burimit duke qenë se ai punon direkt brenda kontekstit. Specialisti i fushës njih konceptin që dëshiron të përdorë. Atij duhet t'i sjellësh në mend strukturën terminologjike ekzistuese të fushës së vet për qëllime verifikimi dhe krijim termash. Jospécialistit i duhet thjesht një shpjegim në formën e '*përkufizimit enciklopedik*', meqenëse ky lloj përkufizimi rezulton me përfitim për të.


Tradicionalisht, pozicioni teorik lidhur me përkufizimet është ai klasik ku jepen: *gjinia-klasa-kategoria-nënklasa-tipi/lloji*, si p.sh., *makinë bujqësore-vegël bujqësore- vegël krahu-vegël për punimin e tokës-vegël për punimin e tokës me këmbë-bel*.

Duke u mbështetur në studimin e Sager-it¹³, po paraqesim gamën e plotë të përkufizimeve që përdoren në fushën e terminologjisë së agromekanikës.

1. Përkufizimi përmes analizës (diferencimi gjini/klasë)
plug: vegël bujqësore për të lëruar tokën ose për të hapur vija kulluese;
lesë: vegël bujqësore për të copëtuar plisat, për të shtruar dheun ose për të mbuluar farën në are;
frezë: makinë e posaçme që shërben për t'i dhënë trajta të ndryshme sipërfaqes së një sendi prej metali ose prej druri”;
2. Përkufizimi me anë të sinonimisë:
branë -lesë
prashajkë -capë
sfurk- pirun

¹³ J. S. Sager, *A Practical course in terminology processing*, John Benjamins Publishing Company, Amsterdam, 1990.

3. Përkufizimi me perifrazim:
 - lesim*: procesi i kalimit të lesës për të copëtuar plisat, për të shtruar dheun ose për ta mbuluar;
 - frezim*: procesi i dhënies të trajtave të ndryshme sipërfaqeve prej metali ose druri;
 - plugim*: procesi i lërimit të tokës ose hapjes së vijave kulluese me plug.
4. Përkufizimi me anë të sintezës (identifikimi i marrëdhënieve, me anë të përshkrimit);
 - bel*: vegël bujqësore si lopatë, me teh trekëndësh, zakonisht me një këmbëz, që përdoret për të punuar thellë tokën ose për të hapur hendek;
 - lopatë*: vegël krahu, me një pjesë të metaltë, të gjerë e pak të lakuar dhe me bisht të drunjtë, që përdoret për të hequr dhe, për punë bujqësore e për punë të tjera”;
5. Përkufizimi me implikim (duke përdorur një fjalë në një kontekst shpjegues)
 - dhëmbë*: lesa me cilindër ka dhëmbë që përdoren për thërrmim dhe ngjeshje
 - kunj*: lesa me cilindër ka kunj që përdoren për të çarë dhe thërrmuar tokën;
 - yllëza*: lesa me cilindër ka yllëza që përdoren për copëtim a ngjeshje.
6. Përkufizimi me shënimin e kuptimit të saktë (duke listuar shembuj, apo duke zgjeruar rrethin e termave)
 - vegël krahu: =veglat e krahut janë lopata, beli, kazma, shati, capa, etj.
 - vegël prerëse: =kosa, drapri, kosorja, makinë prerëse, thika, brisku
7. Përkufizimi përmes demonstrimit (përmes shembujve, vizatimeve, fotografi)



Duke demonstruar objektin (*Ky është një plug*),

Shumë përkufizime paraqiten edhe të përziera:

- a) Përmes analizës dhe përshkrimit:
 - kultivator*: Makinë bujqësore e pajisur me plorë të vegjël, që përdoret kryesisht për prashitje. *Kultivator me dorë. Kultivator prashitës. Punimi me kultivator. Hap vija me kultivator.*
- b) Me sinonimi dhe përshkrim:

branë: Lesë, vegël bujqësore për të copëtuar plisat, për të shtruar dheun ose për të mbuluar farën në are;

Si përfundim, nga shembujt e mësipërm, vihet re se terminologjia paraqet interes dhe sfidë si për specialistin e fushës, ashtu edhe për terminologun, i cili është i përfshirë direkt në punën e tij me termin. Termi paraqet interes dhe duhet parë me karakteristikat e konceptit. Përkufizimet dhe parimet që burojnë prej tyre duhet të udhëheqin punën tonë në hartimin e fjalorëve terminologjikë në të gjitha fushat e jetës.

BIBLIOGRAFI

- Bello, V., *Leksiku terminologjik i gjuhësisë në gjuhën shqipe*, Disertacion, Tiranë, 2009.
- Cabre, M. T., *Terminology: Theory, methods and applications*, John Benjamins, 1999.
- Duro, A., “Marrëdhëniet fjalë-kuptim dhe term-koncept në këndvështrimin e akademikut Jani Thomai”, *Studimet gjuhësore-terminologji-gjuhësi kompjuterike dhe kritikë-bibliografi*, Tiranë, 2012.
- Felber, H., “Basic principles and methods for the preparation of terminology standard”, *Standardization of technical terminology: principles and practices*, Heyman editore, 1983.
- Felber, H., *Terminology manual*, UNESCO and Infoterm, Paris, 1984.
- Lerat, P. 1988, “Terminologie et sémantique deskriptive”, *La banque des mots*, numéro spécial, p. 11-30.
- Rëndësia e terminologjisë*, në:
<http://www.computing.surrey.ac.uk/ai/pointer/report/section1.html>
- Sager, J. S., *A Practical course in terminology processing*, John Benjamins Publishing Company, Amsterdam, 1990.
- Wüster, E., *The machine tool – An interlingual dictionary of Basic concepts*. London: technical Press, 1931.

